



GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE
NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2016/2017

UDHËZIM

Koha për zgjidhjen e testit është **70 minuta**.

Mos e hapni testin dhe mos filloni t'i zgjidhni detyrat derisa të mos ju japë leje mësimdhënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruani lexueshëm me shkronja dore.

Nëse shkruani me shkronja shtypi, theksojeni shkronjën e madhe aty ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar me rastin e zgjidhjes së detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon të përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test.

Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero (0) pikë nëse:

- është e pasaktë
- është e palexueshme dhe nuk është shkruar qartë përgjigjja
- është e shkruar me laps të thjeshtë
- është shkruar ose qarkuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

Lexo tekstet 1 dhe 2 pastaj zhvillo detyrat 1, 2 dhe 3.

TEKSTI 1

Për shkak të organizimit të shkollës së notit për nxënës, prej më 5 deri më 19 janar, gjatë pushimit dimëror pezullohen afatet vijuese të notit rekreativ për qytetarët:

- të hënë: 12 – 14 h
- të martën: 11.30 – 13.30 h
- të mërkurën: 12 – 14 h
- të enjten: 10.30 – 12.30 h
- të premten: 12 – 14 h

Drejtorja e
IP të Qendrës Sportive

TEKSTI 2

NJOFRIM
MË DATËN 8.12.2015. NUK
DO TË KETË UJË PREJ ORËS
8.30 MINUTA PËR SHKAK
TË ZHVILLIMIT TË PUNIMEVE
NË BODRUM

1. Njoftimi i dytë është:

1. publik
2. privat
3. zyrtar

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

2. Nënvizu dy pyetje të cilat janë të përbashkëta për të dy njoftimet.

1. Kush njofton?
2. Kë e njofton?
3. Kur do të ndodh ajo?
4. Përse do të ndodh ajo?

1 pikë

3. Cilat ditë pre orës 12 deri në orën 14 nuk do të mbahen afatet e notimit rekreativ për qytetarët?

1 pikë

Lexo me kujdes fragmentin nga tregimi Jermollaj dhe mullisja dhe zgjidhi detyrat 4, 5, dhe 6.

Jermollaj dhe mullisja

1. Para mbrëmjes jam nisur në “pritë” me gjahtarin Jermollaj. Mirëpo ndoshta të gjithë lexuesit e mi nuk e dinë çfarë është “prita”. E, po dëgjoni, zotërinj!
Në pranverë, një çerek ore para perëndimit të diellit, hyni në pyll me pushkë, pa qen. Gjeni ndonjë vend diku në periferi të pyllit, shikoni rreth e rrotull vetes, kontrolloni kapsollën, ia shkelni syrin tjetrës. Një çerek ore kaloi. Dielli ka perënduar, por në pyll ka ende dritë; ajër të pastër dhe tejpashmëri; zogjtë çuçurisin; bari i njomë është i mbushur me një shkëlqim të hareshëm ... ju prisni. Në thellësi pylli dalëngadalë errësohet; drita e purpurt dhe të kuqërremtit e mbrëmjes ngadalë rrëshqet nëpër damarët dhe trungjet e drurëve, ngrihet gjithnjë e më shumë, nga degët e ulëta dhe të zhveshura, kalon në majat e palëvizshme dhe zhytura në ëndrra ... Në pyll ishte gjithnjë e më errët. Drurët shkriheshin në një masë të madhe e cila bëhej gjithnjë e më e zezë; në qiellin e kaltër shfaqen me frikë yjet e para. Të gjithë zogjtë kanë rënë në gjumë... Zemra ju shuhet nga pritja, dhe përnjëherë – por vetëm gjahtarët do të më kuptojnë – aty për aty në heshtjen e thellë u dëgjua krokëritja dhe fishkëllima e llojit të veçantë, dëgjohej goditja e barabartë e krahëve të shpejtë, dhe shapka, duke e dredhur bukur sqepin e saj të gjatë, fluturoi lehtë nga mështekna e errët duke ardhur në drejtimin tonë.
Ja çfarë është “prita”.
2. Dhe kështu unë me Jermollajin përgatitem për pritje; por, më falni, zotërinj, fillimisht duhet t’ju njoftoj me Jermollajin. Ai është një njeri rreth dyzet vjeç, shtatlartë, i hollë, me një hundë të madhe dhe të hollë, me ballë të ngushtë, me sy ngjyrë hiri, me flokë të shprishur dhe buzë të gjëra dhe të qeshura të gojës. Ai njeri verës dhe dimrit shkante në një pallto me qepje gjermane, por ngjishej me qen; barte pantallona të kaltra dhe të gjëra dhe një kapuç prej leshit të qengjit, të cilin në një çast gëzimi ja kishte dhuruar një bujar i falimentuar. Rreth brezit lidhte dy thasë të vegjël, njërin përpara, të lakuar artificialisht në dy gjysma, për barot dhe për saçma, - tjetrin prapa - për egërsirë; leshin e nxirrte nga kapuçi i tij qartësisht të pashterur... Kishte një pushkë me një tytë me mbushje nga gryka, e cila „dridhte” fuqishëm, nga e cila Jermollaji gjithmonë e kishte faqen e djathtë më të mbushur se atë të majtën. Si gjuante ai nga ajo pushkë, - atë nuk e dinte as njeriu më dinak, por qëllonte.

(Nga përmbledhja e tregimeve Shënimet e gjahtarit – I. S. Turgenjev)

4. Lexo fjalitë dhe nëse pohimi është i saktë rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë rretho P.

Rrëfyesi dhe gjahtari Jermollaj kanë pritur që ta gjuajnë shapkën.	S	P
Faqja e djathtë e Jermollajit ishte më e mbushur sesa e majta sepse pushka e tij me një tytë dridhte fuqishëm.	S	P
Në tregim qeni është përcjellës besnik i Jermollajit.	S	P

1 pikë

5. Me çfarë forme të rrëfimit është realizuar fragmenti?

1. me monolog
2. me dijalog
3. me rrëfim

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

6. Pjesa e dytë e tekstit është shembull i përshkrimit të:

1. enterierit
2. eksterierit
3. natyrës
4. personazhit

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë	
--------	--

7. A) Në vijën pas fjalëve shkruaj, cila është fonema që e kanë të gjitha këto fjalë.

uthull _____

fillon _____

llamba _____

B) Cilat janë dy fonemat që shërbejnë për të dalluar fjalët e mëposhtme dhe trego çfarë fonemash janë: zanore apo bashkëtingëllore?

vetull – petull _____, _____.

arë – urë _____, _____.

gurë – mure _____, _____.

pullë – pallë _____, _____.

miell – diell _____, _____.

2 pikë	
--------	--

Lexo poezinë me vëmendje dhe më pas përgjigju në pyetjet 8, 9, 10 dhe 11.

Npër ograjë po këndojnë bylbylat
Si tu 'u prallë me shoqi shojnë
Drandofilleve zymylat
T' kandshmen erë dhunti ju çojnë.

E nalt n' qiell e bukur hana
Reze t'paqta shkon tui shkri;
Maje bjeshkve fillon zana
N'valle shoqeve m'u pri.

Lodhë prej vegësh, prej rranjësh shpijet,
Si u ba natë, ndej Zoga n'votrë;
Ndej m'u xe me dru dullijet
Që kish ba npër mal pa motër!

8. Shëno titullin e veprës nga e cila është marrë fragmenti.

1 pikë

9. Si paraqitet Zoga në strofën e fundit?

1 pikë

10. A) Strofa në poezinë e veçuar është:

1. distik
2. tercinë
3. katren

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

B) Si quhet rima që është përdorur në këto vargje?

1 pikë

11. Nga fragmenti i dhënë përshkruaje vargun i cili paraqet simbolikën e asaj se "jeta vazhdon".

1 pikë

12. *Dielli ka perënduar, por në pyll ka ende dritë; ajër të pastër dhe tejpashmëri; zogjtë çuçurisin; bari i njomë është i mbushur me një shkëlqim të hareshëm.*

A) Cakto çfarë domethënie ka folja ÇUÇURISIN në fjalinë e dhënë dhe rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1. flasin gëzueshëm
2. cicërojnë gëzueshëm
3. llomotisin pa pushim

1 pikë

B) Shkruaje emrin e figurës stilistike të nënvizuar nga fjalia e mësipërme. Figura stilistike është:

1 pikë

13. **A) Shkruaje antonimin e mbiemrit *i ri*.**

1 pikë

B) Shkruaje shkallën krahasore dhe shkallën sipërore të mbiemrit *i fuqishëm*.

(krahasore)

(sipërore)

2 pikë

14. *Të mbahet larg fëmijëve.*

A) Në cilën kohë është folja e nënvizuar?

1 pikë

B) Folja e nënvizuar në fjalinë e mësipërme është në formën:

1. veprorë
2. joveprorë

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

C) Në cilën mënyrë është përdor folja në fjalë?

1 pikë

15. Cakto llojin e fjalëve:

atë _____
është _____
nga _____
dyzet _____
gjatë _____
dhe _____
hundë _____

2 pikë

16. *Neritani ishte i gatshëm të mbronte me thonj idetë e tij, por nuk e kishte pritur që do të zhvillonte një debat aq të ashpër me Fisnikun, mikun e tij politikan.*

Fjalës së nënvizuar nga fjalia e dhënë caktoja rasën, trajtën, numrin dhe gjininë.

rasa _____
trajta _____
numri _____
gjinia _____

2 pikë

17. A) Cakto funksionin e fjalëve të nënvizuara në fjali: Dielli kishte perënduar, por në pyll kishte ende dritë.

Dielli _____
kishte perënduar _____
në pyll _____

1 pikë

B) Sqaro përdorimin e presjes në fjalinë nën A.

1 pikë

18. A) Shkruaje numrin me shkronja.

2912

2 pikë	
--------	--

B) Rretho numrin para fjalës së theksuar saktë.

1. búkur
2. málor
3. átdhe

1 pikë	
--------	--

19. A) Rretho numrin para fjalës së shkruar saktë:

1. ndëgjoj
2. dëgjoj
3. nigjoj

1 pikë	
--------	--

B) Rretho numrin para përdorimit të saktë të variantit të parashtesës në fjalën e fjalive të mëposhtme.

1. Sot çfaqet drama e teatrit të shkollës.
2. Unë shlodhem duke lexuar.
3. E zhdëmtoi sipas rregullave.

1 pikë	
--------	--

E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test: _____

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR: _____

Data _____ 2017